



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

UP1: 08-334
26.12.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-334 datë 11.12.2024 dhe Propozimin PA1 nr.08-334 datë 23.12.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-5193/3 datë 25.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024 miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim televiziv

NDALOHET procedura e inicuar për heqje të lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV Njuz SHPKNJP Kumanovë, PA1 nr.08-350 datë 21.11.2022.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 45-të mbajtur më 12.12.2024 me Konkluzion ark.nr.02-5070/2 datë 12.12.2024, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajčevski, Drejtorit të Agjencisë, PA1 nr.08-334 datë 11.12.2024 dhe inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV Njuz SHPKNJP Kumanovë, PA1 nr.08-350 datë 21.11.2022, për faktin se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-5088/1 datë 11.12.2024, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), respektivisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 13.12.2024 drejtuar transmetuesit në fjalë i është dërguar Shkresë PA1 nr.08-334 datë 13.12.2024, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 shihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ 6p.248/18).



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

pranimi të Propozimit për inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Megjithatë, me datë 19.12.2024 drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për Financa dhe Logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-5088/2 datë 19.12.2024, që SHTR TV Njuz SHPKNJP Kumanovë, me datë 13.12.2024 ka kryer pagesë në shumë prej 198.383,00 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) denarë, me datë 17.12.2024 ka kryer pagesë në shumë prej 35.600,00 (tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) denarë dhe më 18.12.2024 ka kryer pagesë në shumë prej 90,00 (nëntëdhjetë) denarë, me të cilën kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv është paguar plotësisht.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-334 datë 11.12.2024 dhe Propozimin PA1 nr.334 datë 23.12.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-5193/3 datë 25.12.2024, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.